



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, me ndryshim plotësimet e bëra me Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.02/2018, dhe neneve 14 dhe 47 paragr.1 dhe 48 paragr.2, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2020, mori:

### VENDIM

#### Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF, si vijon;

- **z.Patriot Rudari** caktohet në vend të z.Avni Fetahu i cili tërhiqet nga pozita e anëtarit të KPF-së
- **z.Vendenis Lahu** caktohet në vend të z.Fitim Haziri i cili është zgjedhë Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- **znj.Endritë Murati** caktohet në vend të znj.Floretë Zejnullahu e cila është zgjedhë Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës

#### Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/02-0014914/18 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 28 shkurt 2018.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-020/04-0032343/20  
Podujevë,  
30 qershor 2020

